



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 283/Prot.
18

Tiranë, më 26.02.2021

VENDIM
Nr. 23, datë 26.2.2021

**“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR
VITIN AKADEMIK 2020-2021, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit Qarkullues nr. 108, datë 29.12.2020 "Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve...", të Senatit Akademik, Vendimit Qarkullues nr. 37 prot., datë 28.04.2020 "Mbi zhvillimin e proceseve akademike në situatën e krijuar nga infeksioni COVID-19 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", si dhe propozimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2020-2021, janë 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë) të ndara si më poshtë:
 - a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 104;
 - b) Kuota pranimi nga Ministria e Mbrojtjes 22;
 - c) Kuota pranimi nga Ministria e Drejtësisë 9;
 - d) Kuota të lira (të pa mbuluara) 145;
 - e) Kuota për transferim të studimeve nga institucione të tjera 5;
2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1/a), b), c), d) dhe e), të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (5 kuota) shpërndahen nga Rektori i UMT-së, bazuar në propozimin e dekanateve sipas kërkesave të aplikantëve që vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë, në programe specializuese afatgjata të njëjta apo të të njëjtit profil. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
4. Kuotat e pranimi për transferim të studimesh (10 kuota) janë në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializimi afatgjatë, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
5. Aplikojnë, për programe studimi specializuese, afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
6. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të udhëzimit përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
7. Tarifa e aplikimi dhe konkurrimit (intervista me gojë) në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifat e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
8. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
9. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/a),b) dhe c) të këtij vendimi duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studentët e shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a),b) dhe c) të këtij vendimi lidhin kontratën me ministrinë përkatëse.

Modeli i kontratës dhe modalitet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësive kryesore përkatëse të UMT-së, pa efekte buxhetore shtesë.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë, Dentare, si dhe Ministrive përkatëse dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit tretë, në fushën e mjekësisë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA



TABELA NR. 1: Shpërndarja e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për vitin akademik 2020-2021

Nr.	NJESIA KRYESORE	PROGRAMI / STUDIUMIT	KUOTA TË MIRATUARA PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 (VISA nr.108, dt.29.12.2020)	KUOTA TË PROPOZUARA NGA MSHMS	KUOTA TË PROPOZUARA NGA MINISTRIA E MBROJTJES	KUOTA TË PROPOZUARA NGA MINISTRIA E DREJTËSISË	KUOTA TË LIRA PAS PROPOZIMEVE TË MINISTRIVE
1	FAKULTETI MJEKËSISË	ALERGOLOGJI DHE IMUNOLOGJI KLINIKE	5		1		4
2	FAKULTETI MJEKËSISË	ANATOMI PATOLOGJIKE	5				5
3	FAKULTETI MJEKËSISË	ANESTEZI-REANIMACION	20	15	1		4
5	FAKULTETI MJEKËSISË	DIAGNOZË ME IMAZHE	5	4	1		0
6	FAKULTETI MJEKËSISË	ENDOKRINOLOGJI	5		3		2
7	FAKULTETI MJEKËSISË	GASTROHEPATOLOGJI	5	2	1		2
8	FAKULTETI MJEKËSISË	HEMATOLOGJI	5	3	1		1
10	FAKULTETI MJEKËSISË	KARDIOLOGJI	10	8	1	1	0
11	FAKULTETI MJEKËSISË	KIRURGJI E PËRGJITHSHME	10	3	1		6
13	FAKULTETI MJEKËSISË	LABORATOR KLINIK-BIOKIMIK	5		1		4
14	FAKULTETI MJEKËSISË	MIKROBIOLOGJI	5				5
15	FAKULTETI MJEKËSISË	MJEKËSI E URGJENCËS	15	10		1	4
16	FAKULTETI MJEKËSISË	MJEKËSI FAMILJE	30	6			24
17	FAKULTETI MJEKËSISË	MJEKËSI INTERNE	10	7		2	1
19	FAKULTETI MJEKËSISË	MJEKËSI TRANSFUZIVE	5				5
20	FAKULTETI MJEKËSISË	NEFROLOGJI	5		1		4
21	FAKULTETI MJEKËSISË	NEUROKIRURGJI	5		1		4
22	FAKULTETI MJEKËSISË	NEUROLOGJI	5	5			0
23	FAKULTETI MJEKËSISË	OBSTETRIKE-GJINEKOLOGJI	10	5	1		4
25	FAKULTETI MJEKËSISË	ONKOLOGJI	10		1		9
26	FAKULTETI MJEKËSISË	ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJI	5	2	1		2
27	FAKULTETI MJEKËSISË	OTORINOLARINGOLOGJI	5	4			1
28	FAKULTETI MJEKËSISË	PEDIATRI	20	14	1		5
29	FAKULTETI MJEKËSISË	PNEUMOLOGJI	10	8		1	1
30	FAKULTETI MJEKËSISË	PSIKIATRI	10		1	2	7
31	FAKULTETI MJEKËSISË	PSIKIATRI E FEMJËVE DHE ADOLESHENTËVE	5				5
32	FAKULTETI MJEKËSISË	REUMATOLOGJI	10		3		7
33	FAKULTETI MJEKËSISË	SËMUNDJE INFEKTIVE	20	8	1	1	10
34	FAKULTETI MJEKËSISË	SHËNDET PUBLIK	10				10
36	FAKULTETI MJEKËSISË DENTARE	KIRURGJI ORO-MAKSILLIO-FACIALE	10			1	9
TOTAL			280	104	22	9	145

*5 kuota të miratuara për transferim të studimeve nga institucionet të tjera

*10 kuota të miratuara për transferim të studimeve, kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale